

Vendim nr. 59 datë 23.03.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 23.03.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (B) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: BLERTA ASLLANI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-2856 (361), datë 12.10.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Blerta Asllani ka qenë në marrëdhënie pune pranë shoqërisë “A” sh.a. që prej datës 16.11.2003. Me shkresën nr. 4525/4 prot., datë 21.08.2012, kërkueses i është njoftuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës, duke filluar nga data 22.08.2012, me argumentin se kishte shkelur detyrimet kontraktore, duke mos u paraqitur në punë për më

shumë se 3 ditë pa njoftuar eprorët përkatës, arsye që përbënte shkak të justifikuar për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës në kuptim të nenit 153 të Kodit të Punës. Në datën 19.11.2012 kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, me pretendimin se kontrata e punës ishte zgjidhur në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur, shoqërisë “A” sh.a., për t’i paguar asaj dëmshpërblimet përkatëse.

2. Me vendimin nr. 1318, datë 13.02.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: *“1. Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë; 2. Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë palën paditëse me 8 (tetë) paga mujore për zgjidhje të kontratës individuale të punës në mënyrë të menjëhershme, të pajustificuar dhe në kohë të papërshtatshme sipas nenit 155/3 të Kodit të Punës. 3. Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë palën paditëse me 3 (tre) paga mujore për mosrespektim të afatit tremujor të njoftimit sipas nenit 143, pika 1, të K.Punës. 4. Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë palën paditëse me 2 (dy) paga mujore për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës individuale të punës sipas nenit 144 të K.Punës. 5. Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë palën paditëse me 4 (katër) paga mujore shpërblim për vjetërsi në punë sipas nenit 145 të K.Punës. 6. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë palës paditëse të ardhurat për barrë lindje në shumën 35.880 lekë për periudhën e barrë lindjes nga data 01.08.2012 deri në datën 25.08.2012. 7. Si pagë referuese do të merret paga që ekzistonte në përfundim të marrëdhënies së punës. 8. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër...”*. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkesja dhe pala e paditur në këtë proces, shoqëria “A” sh.a.

3. Me vendimin nr. 2640, datë 13.06.2014, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 1318, datë 13.02.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”*. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs shoqëria “A” sh.a.

4. Me vendimin nr. 00-2022-2856 (361), datë 12.10.2022, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 2640, datë 13.06.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate me tjetër trup gjykues.”*, me argumentin se gjykimi i zhvilluar nga gjykatat e faktit është rrjedhojë e një procesi jo të drejtë dhe e një hetimi jo të plotë e të gjithanshëm të mosmarrëveshjes.

5. Kërkesja, në datën 08.02.2023, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimit objekt kërkesë.

II

Pretendimet e kërkeses

6. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimit objekt kërkesë, duke pretenduar se i është cenuar:

- 6.1. *E drejta e aksesit, e drejta për t'u dëgjuar dhe parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve*, pasi rekursi i palës së paditur nuk i është njoftuar kërkueses, duke i mohuar të drejtën e kundërrekursit. Vendimi i gjykatës së apelit është ekzekutuar në mënyrë vullnetare dhe për këtë shkak kërkuesja nuk ka pasur arsye të dyshojë për ekzistencën e rekursit. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë asaj mundësi të mbrohet efektivisht.
- 6.2. *Parimi i gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë i ka shqyrtuar në themel provat, duke kryer një hetim dhe vlerësim të tyre, ndryshe nga funksioni i saj si gjykatë ligji. Konkretisht, Gjykata e Lartë ka vlerësuar rëndësinë e e-mail-it të datës 21.06.2012, si provë decizive për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ndërkohë që gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë kryer një hetim të plotë të të gjitha akteve të paraqitura nga palët. Gjithashtu, Gjykata e Lartë e ka konsideruar Manualin e Punonjësve si një dokument privat të hartuar nga pala e paditur, që është shprehje e vullnetit të saj për vendosjen e rregullave dhe kushteve aksesore të punëmarrësit në marrëdhënien e punës, kur ndërkohë ai është pjesë përbërëse e kontratës së punës, në të cilën janë parashikuar rregulla të posaçme për shprehjen e vullnetit në rastin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Gjykata e Lartë nuk ka e vlerësuar drejt sjelljen e palës së paditur në atë proces dhe qëllimin e saj për largimin nga puna të kërkueses.
- 6.3. *Parimin e paanshmërisë*, pasi Gjykata e Lartë ka treguar njëanshmëri dhe paragjykim për mosmarrëveshjen konkrete.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkueses

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat

negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Në rastin konkret, Kolegji vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi objekt kundërshtimi dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Një kriter tjetër paraprak lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata Kushtetuese bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

11. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike nënkupton se kërkuuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimet nr. 13, datë 09.03.2021; nr. 56, datë 25.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, kjo do të thotë se mund të kërkohej vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e vendimit nr. 00-2022-2856 (361), datë 12.10.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2640, datë 13.06.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate me tjetër trup gjykues.

13. Gjykata ka pohuar se vendimet gjyqësore që kthejnë çështjen për rigjykim nuk mund të konsiderohen si vendime përfundimtare, për efektet e gjykimit kushtetues, pasi ato nuk vendosin në mënyrë përfundimtare për themelin e çështjes. Në të tilla raste kërkuuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes,

përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*shih vendimin nr. 39, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se në kushtet kur çështja është kthyer për rigjykim dhe procedurat gjyqësore për shqyrtimin e saj nuk kanë përfunduar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, kërkesja ka ende mjete ligjore në dispozicion për të paraqitur pretendimet e saj për të drejtat që pretendon se i janë shkelur.

15. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.